g) **Dispozitivi diferencial të tipit B**  janë ata dispozitivë që funksionojnë rregullisht brenda kufijve të përcaktuar në prani të rrymave të avarisë si të llojit alternativ ashtu edhe të komponentëve alternativë të shoqëruar me pulsime njëdrejtëshe, si dhe të rrymave të vazhduara.

g) **Dispozitivi diferencial me veprim me vonesë kohë (selektive)**  është çdo dispozitiv diferencial e tipit (A, AC dhe B) mund të jenë e tipit S. Ata shfaqin një vonesë kohë veprimi (ose pajisje të rregullueshme). Ata përdoren për kryerjen e selektivitetit diferencial.

h) **Dispozitivi diferencial të imunizuara nga ndërhyrjet e menjëhershme**  janë ata dispozitivë diferenciale të imunizuar ndaj ndërhyrjeve të valëve të rrymës të tipit impulsiv, që qarkullojnë nëpër kapacitetin në ajër që krijohet midis instalimit elektrik dhe tokës për shkak të mbitensioneve të shkaktuara nga rrufeja ose manovrimi me ngarkesa të mëdha në rrjetin e energjisë.

i) **Vendosje në treg/shërbim** e dispozitivi diferencial është bërja e disponueshme për herë të parë në treg e dispozitivit diferencial.

j) **Vlerësim i konformitetit** i dispozitivit diferencial është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara në këtë rregull teknik për një dispozitiv diferencial.

k) **Inspektim periodik** i dispozitivit diferencial është procesi i ekzaminimit të një dispozitivi diferencial, procesit apo instalimit, dhe përcaktimi i përputhshmërisë së tij me kërkesat specifike të këtij rregulli teknik ose, sipas gjykimit profesional, me kërkesat e përgjithshme.

l) **Personi përgjegjës** i dispozitivit diferencial është titullari i së drejtës së pronësisë mbi dispozitivin diferencial ose personi që ka atë në gëzim të përkohshëm, nëse ky i fundit ka detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së dispozitivit diferencial me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në bazë të një marrëveshje me pronarin apo të një akti administrativ ose sipas rastit, punëdhënësi për dispozitivin diferencial e vendosur në vendin e punës.

ll) **OM** është organ i miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë elektrike, në përputhje me kreun V të ligjit, nr. 10489, datë 15.12.2011, i ndryshuar.

6. Lloje të ndryshme të dispozitivin diferencial

Në lidhje me parametrat karakteristikë mund të identifikohen disa lloje të dispozitivëve diferenciale. Në tabelën 1 janë mbledhur llojet më të përhapura të dispozitivëve diferenciale.

Tabela 1 - Klasifikimi i dispozitivëve diferenciale

Parametrat e klasifikimit	Tipologjia
Mbrojtja nga mbirryma	Pa ndërprerës të mbirrymave (të pastra)
	Me ndërprerës magnetotermikë
	Të adaptuar me ndërprerës magnetotermikë nga instaluesi
Destinacioni i përdorimit	Përdorim familjar e të ngjashme
	Përdorim të përgjithshëm
Mënyra e ndërhyrjes në funksion të tensionit të rrjetit	Me funksionim të varur
	Me funksionim të pavarur
Lloji i rrymës së rrjedhjes të aplikuar	Tipi AC
	Tipi A
	Tipi B
Vonesa e veprimit	Me mbajtje kohe (selektive)
	Pa mbajtje kohe
Rregullimi	E rregullueshme
	E parregullueshme
Kompozimi	Monobllok
	E bashkuar (kompozuar)

7. Mbrojtja e dispozitivëve diferencialë nga mbirrymat

Dispozitivët diferencialë duhet të kenë të parashikuar mbrojtjen nga mbirrymat. Për realizimin e një mbrojtje të tillë në dispozitivët diferencialë pa ndërprerës magnet-termik (diferenciale e pastër), mund të përshtatet ose të shtohet një mbrojtje magnet-termike. Kur dispozitivi diferencial është i pastër (pa ndërprerës të mbirrymës, të inkorporuar brenda dispozitivit), ai duhet të mbrohet nga mbirrymat dhe lidhjet e shkurtra. Dispozitivi diferencial, i lidhur me ndërprerësin përkatës, duhet të jetë në gjendje të përballojë vlerat e energjisë specifike (I^2t) dhe rrymat pik (I_p), të cilat janë deklaruar nga prodhuesi. Ndërprerësi duhet të zgjidhet me karakteristika të energjisë specifike I^2t dhe të rrymës së pikut I_p jo më të larta se ato të deklaruara në mënyrë specifike nga prodhuesi për dispozitivin diferencial. Për shembull, duke iu referuar figurave 1 dhe 2, duke krahasuar karakteristikat e dhëna për ndërprerësin me vlerat e I^2t (50000 A²s) dhe I_p (4500 A), që suporton pajisja diferenciale mund të gjejmë vlerën maksimale të rrymës (4000 A) për të cilën dispozitivi diferencial rezulton i mbrojtur kundrejt lidhjeve të shkurtra.




Figura 1. Koordinimi i dispozitivit diferencial me ndërprerësin. Verifikimi i I^2t




Figura 2. Koordinimi i dispozitivit të pastër kundër mbingarkesës




Figura 3. Shembull i koordinimit në mes të ndërprerësve dhe dispozitivit diferencial të pastër kundër mbingarkesës

Për dispozitivët diferencialë të destinuar për t'u përdorur në instalime të mjediseve familjare apo të ngjashme me to, ku përdoruesi i instalimit nuk ka kualifikime specifike në fushën elektrike, nevojitet të instalohen dispozitivë diferencial me mbrojtje magneto-termike të inkuorporuar, apo të shtuar nëse nuk është e inkuorporuar. Në bllokun diferencial duhet të tregohet në mënyrë të dukshme simboli i treguar në figurën 4.




Figura 4. Simboli duhet të jetë i dallueshëm edhe pas montimit të dispozitivit diferencial në blloqe të përbashkëta me ndërprerës magnetotermik edhe/ose ndërprerës të tjerë

8. Ndjeshmëria ndaj rrymave pulsante e të vazhdueshme

Përdorimi i gjerë i pajisjeve elektronike si për përdorime civile dhe industriale mund të rezultojë në rastin e një dëmtimi izolimi, me rryma rrjedhje në tokë josinusoidale dhe shpesh me rryma pulsante (fig. 5). Në situata të tilla, një pajisje diferenciale nuk është gjithmonë e përshtatshme për funksionin e duhur. Në lidhje me rrymat rrjedhëse që kalojnë në dispozitivin diferencial, ato klasifikohen në tre tipa AC, A dhe B.




Figura 5. Tipat e dispozitivëve diferencialë në varësi të rrymës së veprimit (I_{Δ})

9. Selektiviteti ndërmjet dispozitivëve diferenciale

Selektiviteti nënkupton veprimin e dispozitivit diferencial që ndodhet më afër pikës së dëmtimit të izolacionit të pajisjes kundrejt tokës, ndërkohë që pjesa tjetër e sistemit funksionon rregullisht. Selektiviteti diferencial mund të realizohet në mënyrë horizontale ose vertikale.

Funksionimi i selektivitetit horizontal tregohet në figurën 6.




Figura 6. Shembull i selektivitetit horizontal ndërmjet ndërprerësve të qarkut

Funksionimi i selektivitetit vertikal tregohet në figurën 7.




Figura 7. Shembull i selektivitetit vertikal ndërmjet ndërprerësve të qarkut



Për të arritur selektivitetin e veprimit dhe mund të kërkojë vendosjen e një releje me mbajtje kohe (S) për të realizuar vonesën krahasuar me kohën e veprimit të dispozitivëve normalë (g), siç jepen në tabelën 2 më poshtë.

Tipi	Koha e ndërhyrjes (s)	Rryma diferenciale			
		$I_{\Delta n}$	$2 I_{\Delta n}$	$5 I_{\Delta n}$	500 A
Selektive (S)	maksimale	0,5	0,2	0,04	0,04
	maksimale	0,13	0,06	0,05	0,04
Normale (n)	maksimale	0,3	0,15	0,04	0,04

Tabela 2. Krahasoni i kohës së përgjigjes të tipit selektiv (S) dhe llojit normal (n)

10. Detyrimet e instaluesit të dispozitivit diferencial

a) Instalimi i dispozitivit diferencial mund të bëhet vetëm nga instalues të certifikuar nga një organ certifikues personeli i akredituar për fushën përkatëse dhe i miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë sipas procedurës në ligjin nr. 10489/2011.

b) Instaluesi i dispozitivit diferencial në përfundim të instalimit duhet të lëshojë për llogari të personit përgjegjës të pajisjes diferenciale “deklaratën e konformitetit” të këtij instalimi. Modeli i deklarates së konformitetit jepet në aneksin I.

11. Detyrimet për inspektimin periodik të dispozitivit diferencial

a) Personi përgjegjës i pajisjes, implantit, instalimit elektrik duhet t’ia nënshtrojë dispozitivin diferencial inspektimit periodik nga një OM, duke u mbështetur në kërkesat e dhëna në pikën 13 të këtij rregulli teknik. Periodiciteti i inspektimit të dispozitivit diferencial jepet në aneksin II.

Me kërkesë të personit përgjegjës për dispozitivin diferencial në përdorim, një OM e përzgjedhur nga ai kryen inspektimin e dispozitivit diferencial në përputhje me kërkesat e referuara në pikën 13 të këtij rregulli teknik.

b) Inspektimi periodik i dispozitivit diferencial kryhet nga OM-ja, duke u mbështetur në dokumentacionin shoqërues të dispozitivit diferencial, si dhe kërkesat teknike të përcaktuara në këtë rregull teknik.

c) Personi përgjegjës i pajisjes, implantit apo instalimit elektrik, është i detyruar të regjistrojë implantin apo instalimin elektrik së bashku me dispozitivin diferencial të instaluar në to, pranë ISHTI-së.

d) Në përfundim të inspektimit të kryer, OM-ja lëshon për llogari të personit përgjegjës të dispozitivit diferencial një “certifikatë inspektimi”

shoqëruar nga raporti i inspektimit/testimit. Ky dokument ruhet nga OM-ja për një periudhë të paktën 10-vjeçare dhe nga personi përgjegjës jo më pak se deri në inspektimin e radhës dhe zëvendësimin me dokumentin e ri.

12. Detyrimet e strukturës përgjegjëse

a) Struktura përgjegjëse për sigurinë e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)), ushtron inspektime të programuara dhe, sipas rastit, jashtë programit ndaj personave përgjegjës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike dhe garanton zbatimin rigoroz të këtij rregulli teknik.

b) Mospajisja me dispozitiv diferencial, si dhe mosrespektimi i afateve të inspektimeve përbën përgjegjësi për personin përgjegjës të pajisjes, implantit dhe instalimit elektrik dhe ISHTI-ja ndërmerr masat ligjore të parashikuara në aktet ligjore përkatëse.

13. Kërkesat teknike për instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial në përdorim

Dispozitivi diferencial instalohet vetëm nga instalues që plotësojnë kërkesat e pikës 10. Instalimi i dispozitivit diferencial bëhet në mënyrë të tillë që të sigurojë funksionimin e duhur, me qëllim garantimin e mbrojtjes së jetës së njerëzve nga kontaktet e mundshme me rrymën elektrike.

Pajisjet elektrike, të cilat mbrohen me dispozitiv diferencial, duhet të jenë të tokëzuara. Përcjellësi i tokëzimit duhet të jetë i veçantë nga i nulit të rrjetit elektrik nga pika e furnizimit deri te pajisja.

Instalimi i dispozitivit diferencial prezumohet se plotëson kërkesat e lartpërmendura, kur janë zbatuar standardet e harmonizuara shqiptare, që janë listuar në aneksin III të këtij rregulli teknik.

Dispozitivit diferencial i bëhen provat, me qëllim kontrollin e verifikimit të funksionimit



korrekt të impianteve të mbrojtura nga dispozitivi diferencial, i cili i shoqëruar me çkyçësin (automatin magneto- termik), duhet të sigurojë çkyçjen automatike të furnizimit me energji elektrike për rrymë veprimi Δn brenda kohës së vep rimit. Qarqet fundore të mbrojtur nga dispozitivi diferencial me rrymën diferenciale I Δn 10 deri 30 mA, provohen nga:

- mosveprimi me rrymën diferenciale $\frac{1}{2}$ I Δn
- veprimi korrekt me rrymën diferenciale I Δn
- veprimi brenda 40 ms me rrymën diferenciale 250 mA.

Qarqet fundore të mbrojtur nga dispozitivi diferencial rrymën diferenciale $\Delta n \geq 30$ mA, provohen nga:

- mosveprimi me rrymën diferenciale $\frac{1}{2}$ I Δn
- veprimi korrekt me rrymën diferenciale I Δn
- veprimi brenda 40 ms me rrymën diferenciale 5 x I Δn .

Qarqet fundore të mbrojtur nga dispozitivi diferencial i tipit A për rrymën diferenciale alternative, i cili pulson në mënyrë njëdrejtimëshe, provohet nga:

- mosveprimi me rrymën diferenciale $\frac{1}{2}$ I Δn
- veprimi korrekt me rrymën diferenciale I Δn
- veprimi korrekt me një rrymë diferenciale pulsuese dhe me një gjysëmperiode me vlerë efikase $1,4 \times I \Delta n$ mbivendosur mbi rrymë vazhduar 6 mA.

ANEKSI I

DEKLARATA E KONFORMITETIT (Për instalimin e dispozitivit diferencial)

N. _____

I nënshkruari _____

Titullar ose përfaqësues ligjor i shoqërisë _____

Operues në sektorin _____

Me seli në _____

Bashkia _____

Tel. _____ INUS _____

Instalues i impiantit _____

shënuar si: implant i ri ☐, transformim ☐, zgjerim ☐, ristrukturim ☐, të tjera ☐ ¹.

Fuqia maksimale e përdorimit _____

Adresa e plotë e personit përgjegjës të impiantit _____

Lloji i impiantit: industrial ☐ civil ☐ tregtar ☐ të tjera ☐

DEKLAROJ:

Nën përgjegjësinë time personale se implanti është realizuar konform kërkesave ligjore dhe këtij rregulli teknik, dhe veçanërisht:

☐ në zbatim të projektit të hartuar _____☐ në zbatim të ligjeve, standardeve, rregullave teknike _____☐ janë instaluar _____☐ është kontrolluar implanti dhe _____

¹ Si shembull me “të tjerë” mund të interpretohet zëvendësimi i një dispozitivi të montuar.

**Bashkëlidhje të detyruara:**

- ☐ projekti elektrik i hartuar nga _____²
- ☐ ligji, standardi, rregulli teknik _____³
- ☐ tipologjia e materialeve të përdorura _____
- ☐ skema e impiantit të realizuar _____
- ☐ referenca ose deklarata të konformitetit të mëparshme, nëse ekzistojnë _____
- ☐ kopja e certifikatës së kërkesave teknik-profesionale _____

Bashkëlidhje fakultative:**PËRJASHTOJ:**

Çdo përgjegjësi për dëmtimin e njerëzve, kafshëve shtëpiake dhe pronës, që vjen nga ndërhyrja në impiantin e realizuar nga palë të treta ose nga mungesa e mirëmbajtjes dhe riparimit.

PËRFAQËSUESI TEKNIK**DEKLARUESI**

Data _____

(emri, mbiemri e firma)

(emri, mbiemri e firma)

Shënim për klientin: përgjegjësia e personit përgjegjës ose pronarit

Personi përgjegjës ose pronari: _____ data _____

(emri, mbiemri e firma)

ANEKSI II

Afatet e inspektimit dhe vlerësimit të konformitetit të dispozitivit diferencial

Nr.	Lloji i dispozitivit diferencial	Lloji i testimit	Afati i testimit	Kush e kryen
1	Kontroll fillestar	Sipas pikës 13	Pas instalimit	OM
2	Kontroll nëpërmjet butonit “test”		Çdo 3 muaj	Përdoruesi
3	Kontroll periodik	Sipas pikës 13	Çdo 1 vit	OM
4	Kontroll jashtë radhe	Sipas pikës 13		OM ⁴
5	Kontroll sipas kërkesës	Sipas pikës 12, germa “a”, paragrafi i dytë		OM ⁵

² Tregohet: emri, mbiemri, kualifikimi, kur ka lindur detyrimi, ekstremitetet e licencës, të dhëna për hartuesin e projektit.

³ Citohej ligje e rregulla teknike, referimi mbi projektin, zbatimin dhe vlerësimin.

⁴ Konsiderohen kontrolle jashtë radhe kontrollet që kryhen me kërkesë të përdoruesit (personit përgjegjës) të dispozitivit diferencial, kur gjatë kontrollit me butonin “Test” dispozitivi diferencial nuk ka vepruar.

⁵ Vetëm për persona përgjegjës, përdorues familjarë.



ANEKSI III

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE
QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË INSTALIMEVE
TË DISPOZITIVIT DIFERENCIAL ME KËRKESAT TEKNIKE TË INSTALIMIT

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adaptimit si standard shqiptar SSH	Mënyra e adaptimit (me faqe të parë, Fp, ose me përkthim të plotë Pp)	
1	S SH EN 61008-1:2004 Pajisjet ndihmëse elektrike - Ndërprerësit automatikë që veprojnë me rrymë diferenciale pa mbrojtje integrale të mbirrymës për përdorime familjare ose të ngjashme me to - Pjesa 1: Rregulla të përgjithshme		Pp	
2	S SH EN 60947-2:2006/A2:2013 Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut		Pp	
3	S SH EN 60038:2011, Tensionet standarde të IEC-së		Pp	
4	S SH EN 60051-1:1998 (te gjitha pjesët), Mjetet matëse elektrike me tregim analog të një veprimi direkt dhe pajisjet ndihmëse të tyre - Pjesa 1: Përcaktime dhe përshkrime të përgjithshme të përbashkëta për të gjitha pjesët		Pp	
5	S SH HD 60364-5-534:2008, Instalimet elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-53: Përzgjedhja dhe ngritja e pajisjeve elektrike - Izolimi, çkyçja dhe kontrolli – Pika 534: Pajisje për mbrojtjen ndaj mbitensioneve		Pp	
6	S SH EN 60529:1991, Specifikim për shkallët e mbrojtjes që sigurohen nga mbylljet (kodi IP)		Pp	
7	S SH EN 60664-1:2007, Vetitë e izolimit për pajisjet brenda sistemeve me tension të ulët - Pjesa 1: Principet, kërkesat dhe provat		Pp	
8	S SH EN 60695-2-10:2013, Provat në lidhje me rrezikun nga zjarri - Pjesa 2-10: Metodot e provave me tel të nxehur/inkandeshent - Aparatet dhe procedurat e zakonshme të provës me tel-inkandeshent		Pp	
9	S SH IEC 60884-1:2013, Spinat dhe prizat për qëllime shtëpiake dhe të ngjashme me to - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme		Pp	
10	S SH IEC 61009-1:2013, Ndërprerësit automatikë që veprojnë me rrymë residuale me mbrojtje integrale të mbirrymës për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to - Pjesa 1: Rregulla të përgjithshme		Pp	
11	S SH EN 61543:1995, Pajisjet mbrojtëse që veprojnë me rrymë diferenciale për përdorim shtëpiak dhe të ngjashëm me të - Përputhshmëria elektromagnetike		Pp	
12	S SH CISPR 14-1:2005/A1:2008, Përputhshmëria elektromagnetike - Kërkesat për pajisjet elektrike shtëpiake, mjetet elektrike dhe aparaturat e ngjashme me to - Pjesa 1: Emërtimi		Pp	



VENDIM

Nr. 247, datë 30.3.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR E
KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN
NË VOLUM TË SIPËRFAQES PYJORE
PREJ 76.09 HA, NË NGASTRAT 84a, 85a,
85b, 86a, 87b, 88a, 89a DHE 94a, TË
EKONOMISË PYJORE “KRASTË-
KRUIJË”, NË OBJEKTIN “FUSHË-
KRUIJË”, TË QARKUT DURRËS, QË DO
TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“VICTORIA INVEST” SHPK PËR
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË
GURIT GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike, prej 76.09 (shtatëdhjetë e gjashtë pikë zero nëntë) ha, në objektin e quajtur “Fushë-Kruijë”, pjesë e ngastrave 84a, 85a, 85b, 86/a, 87b, 88a, 89a dhe 94a, të ekonomisë pyjore “Kraštë-Kruijë”, që do të përdoret nga shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe të regjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas lidhjes 1, me të dhënat për ngastrat pyjore, dhe hartës topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt mineral, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe të volumit të lëndës drusore paguhen nga shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k. përpara lidhjes së marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit, në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të

Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet që përdor, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 5 (pesë) viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 228.26 (dyqind e njëzet e tetë pikë njëzet e gjashtë) ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.


6. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullësore” dhe ta regjistrojë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet mineral”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k. sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullësor publik.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëria “Victoria Invest” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "VICTORIA INVEST" sh.p.k. në qarkun e Durrësit**

QARKU DURRËS, rrethi Krujë

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullosore	Ngastra	Perdorimi territorit	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
DR 10 84a	Kraste-Kruje	84 a	trungishte	Ministria Mjedisit	3.9806
DR 10 85a	Kraste-Kruje	85 a	trungishte	Ministria Mjedisit	0.3201
DR 10 85b	Kraste-Kruje	85 b	trungishte	Ministria Mjedisit	3.4331
DR 10 86a	Kraste-Kruje	86 a	trungishte	Ministria Mjedisit	0.8758
DR 10 87b	Kraste-Kruje	87 b	trungishte	Ministria Mjedisit	2.4728
DR 10 88a	Kraste-Kruje	88 a	trungishte	Ministria Mjedisit	24.4537
DR 10 89a	Kraste-Kruje	89 a	trungishte	Ministria Mjedisit	21.5856
DR 10 94a	Kraste-Kruje	94 a	trungishte	Ministria Mjedisit	18.9643
GJITHSEJ					76.09

VENDIM

Nr. 248, datë 30.3.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PUBLIK DHE
PAKËSIMIN NË VOLUM TË
SIPËRFAQEVE QË DO TË PËRDOREN
NGA SHOQËRIA TAP-AG PËR
SHTRIRJEN E TUBACIONIT TË
GAZSJELLËSIT TAP, PËR SEKTORËT
4A, 4B DHE 5A, NË QARQET KORÇË,
BERAT DHE FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ligjit 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave;

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 11.557 (njëmbëdhjetë pikë pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) ha, që do të përdoret nga shoqëria TAP AG për ndërtimin e seksionit tokësor të

Gazsjellësit TAP, sektorët 4A, 4B dhe 5A, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që pakësohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor publik, sipas qarqeve dhe bashkive, dhe harta topografike me gjurmën e ndërtimit të tubacionit i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor e të produkteve të tjera pyjore dhe të investimeve të kryera në vite, në pyjet, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria TAP AG, para lidhjes së marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria TAP AG detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet që përdor, sipas kushteve të lejes mjedisore, dhe, brenda 2 (dy) viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, 11.094 (njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) ha sipërfaqe me drurë pyjorë dhe të përmirësojë 2.544 (dy pikë pesëqind e dyzet e katër) ha kullota, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore, sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.



5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore, të identifikuar sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore dhe kullosore” dhe ta regjistrojë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt ndërtimi për segmentin tokësor të gazsjellësit TAP, seksioni 4A, 4B dhe 5A”.


6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, nga shoqëria TAP AG, sipërfaqja pyjore dhe kullosore e rehabilituar të regjistrohet në fondin



pyjor dhe kullosor publik.


7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Bashkia Korçë, Bashkia Poliçan, Bashkia Berat, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Roskovec, Bashkia Fier dhe shoqëria TAP AG, zyra për Shqipërinë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama









LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PUBLIK QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT TOKËSOR
TË TUBACIONIT TË GAZSJELLËSIT TAP , SEKSIONI 4A, 4B DHE 5A
NË QARQET KORÇË, BERAT DHE FIER

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekonomia Pyjore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe preket nga gjurma (ha)</i>
KO66 02 030	Vidhkuq Lubonje	30	Ministria Mjedisit	0.4834
KO66 02 032	Vidhkuq Lubonje	32	Ministria Mjedisit	0.0731
KO66 01 063a	Vidhkuq Lubonje	63a	Ministria Mjedisit	0.0362
KO66 01 063b	Vidhkuq Lubonje	63b	Ministria Mjedisit	0.1242
KO66 01 064a	Vidhkuq Lubonje	64a	Ministria Mjedisit	0.154
KO66 01 064b	Vidhkuq Lubonje	64b	Ministria Mjedisit	0.1455
KO66 03 102a	Vidhkuq Lubonje	102a	NJQV	0.6248
KO66 03 030	Vidhkuq Lubonje	30	NJQV	0.0398
KO66 03 036	Vidhkuq Lubonje	36	NJQV	0.1759
KO66 03 043b	Vidhkuq Lubonje	43b	NJQV	0.0199
KO66 03 043d	Vidhkuq Lubonje	43d	NJQV	0.5296
KO66 03 050b	Vidhkuq Lubonje	50b	NJQV	0.0995
KO66 03 051a	Vidhkuq Lubonje	51a	NJQV	0.2062
KO66 03 051b	Vidhkuq Lubonje	51b	NJQV	0.0499
KO66 03 052a	Vidhkuq Lubonje	52a	NJQV	0.0376
KO66 03 052b	Vidhkuq Lubonje	52b	NJQV	0.055
KO66 03 060a	Vidhkuq Lubonje	60a	NJQV	0.2308
KO66 03 060c	Vidhkuq Lubonje	60c	NJQV	0.1172
KO66 03 061a	Vidhkuq Lubonje	61a	NJQV	0.1809
KO66 03 061b	Vidhkuq Lubonje	61b	NJQV	0.1623
KO66 03 061d	Vidhkuq Lubonje	61d	NJQV	0.0462
KO66 03 063a	Vidhkuq Lubonje	63a	NJQV	0.0647
KO66 03 067a	Vidhkuq Lubonje	67a	NJQV	0.1388
KO66 03 067c	Vidhkuq Lubonje	67c	NJQV	0.0584
KO66 03 067d	Vidhkuq Lubonje	67d	NJQV	0.1415
KO66 03 068a	Vidhkuq Lubonje	68a	NJQV	0.5152
KO66 03 068b	Vidhkuq Lubonje	68b	NJQV	0.2118
KO66 03 068c	Vidhkuq Lubonje	68c	NJQV	0.0915
KO66 03 070	Vidhkuq Lubonje	70	NJQV	0.2108
KO66 03 071a	Vidhkuq Lubonje	71a	NJQV	0.1958
KO66 03 096b	Vidhkuq Lubonje	96b	NJQV	0.0569
KO70 00 001	Zemlak Qarr	1	Ministria Mjedisit	0.3638
KO70 00 173	Zemlak Qarr	173	Ministria Mjedisit	0.5732
KO70 00 174	Zemlak Qarr	174	Ministria Mjedisit	0.6658
KO70 00 176	Zemlak Qarr	176	Ministria Mjedisit	0.2768
Totali Korçe				7.157
BR23 00 056br1	Hija e Roshnikut	56b	NJQV	0.1334
BR23 00 056dr1	Hija e Roshnikut	56d	NJQV	0.4007



BR23 00 056cr1	Hija e Roshnikut	56c	NJQV	0.1617
BR18 00 145cr1	Bregu Balibardhes	145c	NJQV	0.0361
BR18 00 145ar1	Bregu Balibardhes	145a	Ministria Mjedisit	0.1501
BR23 00 010b1	Hija e Roshnikut	10b1	NJ.Q.V	0.320
BR23 00 010c1	Hija e Roshnikut	10c1	NJ.Q.V	0.0367
BR27 00 166br1	Mali Molishtit	166b	Ministria Mjedisit	0.1023
BR27 00 182br1	Mali Molishtit	182b	Ministria Mjedisit	0.5163
BR27 00 169ar1	Mali Molishtit	169a	Ministria Mjedisit	0.0446
BR27 00 181br1	Mali Molishtit	181b	Ministria Mjedisit	0.4534
BR27 00 182cr1	Mali Molishtit	182c	Ministria Mjedisit	0.1502
BR27 00 168br1	Mali Molishtit	168b	Ministria Mjedisit	0.4896
BR27 00 168ar1	Mali Molishtit	168a	Ministria Mjedisit	0.0248
BR27 00 180ar1	Mali Molishtit	180a	Ministria Mjedisit	0.286
BR27 00 179ar1	Mali Molishtit	179a	Ministria Mjedisit	0.0735
BR27 00 180cr1	Mali Molishtit	180c	Ministria Mjedisit	0.0302
BR16 00 001 r1	Ura e Kuçit-Mali-Kules-Mali Shpirag	1	Ministria Mjedisit	0.2538
BR16 00 016/1 r1	Ura e Kuçit-Mali-Kules-Mali Shpirag	16/1	Ministria Mjedisit	0.3519
	Totali Berat			4.0153
FR19014b	Lumi Seman 1	14b	Ministria Mjedisit	0.016
FR08007a	Br. Seman Dermenas	7a	Ministria Mjedisit	0.3508
FR19003a	Lumi Seman 2 Roskovec	3a	Ministria Mjedisit	0.018
	Totali Fier			0.3848
TOTALI				11.557

VENDIM

Nr. 250, datë 30.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 933, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS
ORGANIZATIVE TË QENDRËS
KOMBËTARE TË URGJENCËS
MJEKËSORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, e 25, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Lidhja 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pikën 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Numri i përgjithshëm i punonjësve për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për vitin 2016, është 58 veta dhe për vitin 2017 e në vazhdim është 90 veta.”.

3. Pika 3 ndryshohet dhe bëhet:

“3. Pjesë e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM) është Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore, e cila bën komandinë dhe koordinimin e Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter dhe Shërbimit të Urgjencave Mjekësore. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore është përgjegjëse për trajnimin e personelit mjekësor dhe paramedikal në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore bashkëpunon me organizata të tjera kombëtare ose ndërkombëtare, të autorizuar ose të certifikuar nga institucionet përkatëse në Shqipëri apo në vende të tjera, për kryerjen e trajnimit në fushën e urgjencës mjekësore. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore lidh marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe me institucione të kujdesit shëndetësor.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Njësia e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore është operative 24 orë, për 7 ditë të javës, dhe koordinohet nga përgjegjësit e turnit, të cilët janë mjekë të Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore.”.

5. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:



a) Në shkronjën “b”, pas fjalës “Bashkërendimi...” shtohet fjala “... pjesëmarrja...”.

b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Drejtori i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për mbulimin e shërbimit me personel mjekësor në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter, përzgjedh nga njësitë e urgjencave

mjekësore dhe cakton personelin mjek e infermier sipas një grafiku të paracaktuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe ndryshimet e propozuara në pikën 1 të këtij vendimi, hyjnë në fuqi më 1 janar 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

STRUKTURA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE	
DREJTORI I PËRGJITHSHËM	1
Sekretare	1
Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit	
Drejtori	1
Spektori i Financës/BUXHETIT/INVESTIMEVE	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë finance	3
Llogaritar i mesëm	1
Specialist investimesh (ekonomist, inxhinier)	1
Spektori i Shërbimeve Mbështetëse	
Përgjegjës sektori	1
Specialist i BNJ-së	1
Specialistë IT	2
Specialistë juristë	2
Arkivist	1
Shoferë	2
Sanitare	5
Magaziniër	1
Specialist prokurimi	1
Kordinatorë logjistikë	2
Drejtoria e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore	
Drejtor	1
Spektori i Njësisë së Koordinimit të Urgjencave	
Përgjegjës sektori (mjek)	1
Kryeinfermier	1
Specialistë të lartë (mjekë)	15
Specialistë të lartë (infermierë)	24
Spektori i Trajnimeve, Certifikimeve dhe i Akreditimit	
Përgjegjës sektori	1
Specialist të lartë	3
Spektori i Parandalimit, Kontrollit të Cilësisë dhe Edukimit	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë të lartë	4
Drejtoria e IT, Statistikës dhe Regjistrat të urgjencës	
Drejtor	1



Sektori IT	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë të lartë IT	2
Specialist i lartë inxhinier telekomunikacioni	1
Specialistë të lartë inxhinierë	2
Sektori i Statistikës dhe Regjistrimit të Urgjencës	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë të lartë	2
Operatorë	2
Numri total	90

VENDIM**Nr. 252, datë 30.3.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 109, DATË 26.2.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË
PUNË TË NËPUNËSVE CIVILË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, të kreut I, bëhen këto ndryshime: Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë vijon:

“ç) Zyrtar autorizues, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë zyrtarin kundërfirmues.”.

b) Shkronjat “h” dhe “j” shfuqizohen.

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik.

Vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë.”.

c) Në fjalinë e parë, të pikës 5, fjalët “... si dhe në vlerësimet e kolegëve të të njëjtut nivel në të njëjtin institucion dhe institucione të tjera të administratës shtetërore, me të cilët nëpunësi ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi ...” shfuqizohen.

ç) Në fjalinë e parë, të pikës 6, fjalët “... si dhe në vlerësimet e bëra nga kolegët e të njëjtut nivel në institucionet e tjera të administratës shtetërore ...” shfuqizohen.

d) Në pikën 7, fjalët “... në pikat 7 dhe 8 ...” zëvendësohen me “... në pikat 5 dhe 6, të këtij kreu, ...”.

dh) Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

i) Shkronja “d” shfuqizohet.

ii) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) aftësive menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.”.

e) Në pikën 12 bëhen këto ndryshime:

i) Fjalja e parë, e shkronjës “a”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Zyrtari raportues përkatësisht për secilën periudhë vlerësimi, gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit dhjetor dhe gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit qershor takohet me nëpunësin që do të vlerësohet për të përcaktuar objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit.”.

ii. Në shkronjën “b”, fjalët “Gjatë vitit, çdo katërmujor ...” zëvendësohen me “Në mes të periudhës së vlerësimit ...”.

Fjalja e fundit, e paragrafit të parë, të shkronjës “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Kjo fazë për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1–15 korrik dhe 1–15 janar.”.

ë) Pas pikës 17 shtohet pika 18 me këtë përmbajtje:

“18. Jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, njësia e burimeve njerëzore të institucionit detyrohet të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil.”.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjala e fundit, e shkronjës “ç”, të pikës 1, shfuqizohet.

b) Në pikën 2, togfjalëshi “Zyrtari raportues” zëvendësohet me “Zyrtari kundërfirmues”.

c) Në pikën 6, fjalët “... gjatë vitit të vlerësimit ...” zëvendësohen me “... gjatë periudhës së vlerësimit ...”.

ç) Në pikën 8, fjala “... vjetore ...”, hiqet.

4. Lidhja nr. 2, që përmendet në pikën 1, të kreut IV, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Në pikën 3, të kreut IV, fjalët “... analizë vjetore e punës ...” zëvendësohen me “... analizë 6-mujore e punës ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 2

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PUNËS PËR NËPUNËSIT CIVILË TË KATEGORISË EKZEKUTIVE, TË ULËT DHE TË MESME DREJTUESE

Ndarja A: Të dhëna personale

Emri/mbiemri:

Pozicioni:

Institucioni:

Njësia Organizative:

Drejtoria e Përgjithshme:

Drejtoria:

Sektori:

Vendndodhja:

Data e emërimit në pozicionin aktual:

Periudha e vlerësimit: Data e vlerësimit:

Zyrtari raportues:

Pozicioni i zyrtarit raportues

Siç tregohet nga zyrtari raportues

Lutemi shënoni sipas rastit:

- ☐ Vlerësim vjetor i rezultateve në punë
- ☐ Rishikim i ndërmjetëm
- ☐ Tjetër (specifiko):

Ndarja B: Konteksti i punës

Objektivat e Institucionit për periudhën (siç është përcaktuar në planin e punës të institucionit dhe miratuar nga titullari) janë:

1. Të
2. Të
3. Të

Objektivat e Programit të Njesisë Organizative për periudhën (siç është rishikuar dhe miratuar nga Drejtori i Programit) janë:

1. Të



2. Të

3. Të

Objektivat e Njesisë Organizative ku bën pjesë nëpunësi ()

për periudhën (siç është rishikuar dhe miratuar nga Drejtori i Njesisë Organizative), janë:

1. Të

2. Të

3. Të

Ndarja C: Objektivat dhe matësit e performancës (objektivat duhet të shprehur në mënyrë të tillë që të jenë: specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të përcaktuara në terma kohorë)

Objektivat për periudhën janë:

1. Të.....

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
□4	□3	□2	□1
Objektivi u realizua me vonesë dhe/ose jashtë cilësisë së kërkuar	Objektivi u realizua në kohë dhe me një cilësi të kënaqshme	Objektivi u realizua në kohë dhe me cilësi të mirë	Objektivi u realizua para kohe dhe me cilësi shumë të mirë
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

2. Të.....

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
□4	□3	□2	□1
Objektivi u realizua me vonesë dhe/ose jashtë cilësisë së kërkuar	Objektivi u realizua në kohë dhe me një cilësi të kënaqshme	Objektivi u realizua në kohë dhe me cilësi të mirë	Objektivi u realizua para kohe dhe me cilësi shumë të mirë
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

3. Të.....

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
□4	□3	□2	□1
Objektivi u realizua me vonesë dhe/ose jashtë cilësisë së kërkuar	Objektivi u realizua në kohë dhe me një cilësi të kënaqshme	Objektivi u realizua në kohë dhe me cilësi të mirë	Objektivi u realizua para kohe dhe me cilësi shumë të mirë
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

4. Të.....

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
□4	□3	□2	□1
Objektivi u realizua me vonesë dhe/ose jashtë cilësisë së kërkuar	Objektivi u realizua në kohë dhe me një cilësi të kënaqshme	Objektivi u realizua në kohë dhe me cilësi të mirë	Objektivi u realizua para kohe dhe me cilësi shumë të mirë
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

5. Të.....

**Ndarja Ç: Sjellja profesionale**

Në këtë ndarje, zyrtari raportues komenton në mënyrë të veçantë sa më poshtë:

Gabimet/saktësia në punën e kryer – shpeshësia në kthimin e punës për shkak të pasaktësive në të dhëna ose niveli i lartë i saktësisë që është karakteristike për punën e kryer

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Detyra ka shumë gabime që kërkojnë korrigjim	Detyra ka pak gabime, që kërkojnë korrigjim	Detyra rrallë herë mund të ketë gabime	Detyra kryhet pa gabime dhe shërben si model për të tjerët
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

Realizimi në kohë i punës – numri i rasteve në të cilat puna e kryer është bërë më shpejt ose më ngadalë sesa pritej

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Puna është jashtë afatit	Puna shpesh kryhet me vonesë	Puna rrallë herë kryhet me vonesë	Puna kryhet para afatit
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

Kolegjialiteti i marrëdhënieve – marrëdhënia me kolegët

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Nuk komunikon me kolegët	Çështjet personale me kolegët pengojnë në kryerjen e detyrave	Nëpunësi pëlqehet nga kolegët	Nëpunësi është i parapëlqyer nga kolegët
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

Gatishmëria për punën në grup – në çfarë mase nëpunësi konsiderohet pjesëmarrës i gatshëm dhe produktiv në punën në grup

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Përgjithësisht nuk ka dëshirë të punojë në grup	Nëpunësi është i gatshëm dhe merr pjesë kënaqshëm në punën në grup	Nëpunësi është i gatshëm dhe merr përsipër që të luajë një rol gjatë punës në grup	Nëpunësi është shumë i gatshëm dhe merr përsipër të drejtojë punën në grup
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

Kërkesat për këshillim - masa në të cilën nëpunësit i nevojitet ose kërkon këshilla ose drejtimit teknik, me qëllim që të kryejë punën e ngarkuar: pse ndodh kjo dhe si mund të minimizohet

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Nëpunësi ka vështirësi në të kuptuar/përshtatje dhe ka gjithmonë nevojë për këshillim	Nëpunësi ka kuptueshmëri të kënaqshme dhe ka nevojë për këshillim sipas rastit	Nëpunësit rrallë herë i nevojitet drejtimit teknike për të kuptuar detyrat e ngarkuara	Nëpunësi ka epërsi në të kuptuarit e detyrave



Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			
<u>Aftësia menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues – aftësia për të përdorur me efektshmëri burimet financiare dhe njerëzore</u>			
Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
□4	□3	□2	□1
Nuk siguron përdorimin efektiv të burimeve financiare dhe njerëzore	Siguron që përdorimi i burimeve njerëzore dhe financiare të jetë në nivele të kënaqshme	Ndjek proceset e punës dhe ndërhyrjen që në fazat e hershme për të parandaluar keqmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare	Nxit dhe mbikëqyr zbatimin e strategjive që maksimizojnë vlerën dhe eficientësin e burimeve njerëzore dhe financiare
Komentet e zyrtarit raportues/Shpjegime			

Palët nënshkruese kanë përcaktuar objektivat e punës, matësit e performancës dhe sjelljen e vlerësueshme profesionale dhe miratojnë përdorimin e tyre për ciklin e vlerësimit të rezultateve individuale në punë.

Zyrtarit raportues:.....Firma:

Zyrtari kundërfirmues:.....Firma:

Zyrtari autorizues:.....Firma:

Nëpunësi:.....Firma:

Data:

Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë

Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë është bazuar në performancën e nëpunësit gjatë realizimit të objektivave të mësipërm të miratuara dhe rezultateve të arritura në sjelljen profesionale.

Vlerësimi:

Jo kënaqshëm (4): Nëpunësi nuk i ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale;

Kënaqshëm (3): Nëpunësi ka realizuar kënaqshëm objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional relativisht të mirë;

Mirë (2): Nëpunësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë;

Shumë mirë (1): Nëpunësi ka realizuar shumë mirë të gjitha objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të dalluar nga të tjerët.

Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues	Vlerësimi i zyrtarit raportues
☐ 4	☐ 3	☐ 2	☐ 1
Jokënaqshëm	Kënaqshëm	Mirë	Shumë mirë
Komente të zyrtarit raportues			

Ndarja D: Nënshkrimi

1. Unë deklaroj se kam kryer vlerësimin e mësipërm për nëpunësin.

Nënshkrimi i zyrtarit raportues

Data:

2. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

☐ Jam dakord me vlerësimin

☐ Nuk jam dakord me vlerësimin

Nënshkrimi i zyrtarit kundërfirmues

Data:

3. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

☐ Jam dakord me vlerësimin

☐ Nuk jam dakord me vlerësimin

Nënshkrimi i zyrtarit autorizues

Data:


4. Unë deklaroj se kam marrë dhe kam lexuar vlerësimin e mësipërm.

☐ Jam dakord me vlerësimin;

☐ Nuk jam dakord me vlerësimin.

Nënshkrimi i nëpunësit

Data:





_____ _____ _____ Kërkesë e nëpunësit _____ Rekomanduar nga zyrtari raportues _____ 3. _____ _____ _____ _____ Kërkesë e nëpunësit _____ Rekomanduar nga zyrtari raportues _____	_____ _____ _____ 3. _____ _____ _____ _____
---	---

Rekomandimet/kërkesat e miratuara:
Nënshkrimi i zyrtarit autorizues

Data:

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 476 lekë